



European Platform
tackling undeclared work

#Rights4AllSeasons
#EU4FairWork

**UDHËZUES PËR
PUNËN SEZONALE
TË DEKLARUAR**

ela.europa.eu/en/campaigns/rights-for-all-seasons

HYRJE

Jeni punëtor sezonal?

Sigurohuni të dini gjithçka për të drejtat tuaja!

Të kuptoni të drejtat tuaja mund të jetë e vështirë, sidomos kur kaloni kufijtë kombëtarë për punë sezonale. Për fat të mirë, BE-ja mbron të gjithë punëtorët duke caktuar standardet minimale të punës në 27 Shtetet Anëtare të BE-së. Në këtë broshurë do të mësoni për të drejtat tuaja si punëtor sezonal: që nga kushtet e punësimit, kushtet e punës e plot të tjera.

TË DREJTAT E PUNËS

Çdo punëtor sezonal i deklaruar në BE ka të drejtë për trajtim të barabartë në punësim. Kujdesuni që të informoheni për të mbrojtur interesat tuaja!

Punëdhënësi duhet t'ju ofrojë kontratë të vlefshme pune, e cila duhet të saktësojë:

- ▼ vendin dhe llojin e punës;
- ▼ kohëzgjatjen e punësimit;
- ▼ pagën;
- ▼ orët e punës në javë ose muaj;
- ▼ pushimet e paguara, nëse ka.

Kini parasysh se keni të drejtë të trajtoheni baras me shtetasit e Shtetit Anëtar pritës në BE sa i takon:

- ▼ kushteve të punësimit, përfshirë pagën minimale, moshën për punë dhe kushtet e punës;
- ▼ të drejtave për t'u mbrojtur nga pushimi i pajustificuar nga puna;
- ▼ orëve të punës;
- ▼ pushimeve vjetore dhe lejeve;
- ▼ kërkesave për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

**UDHËZUES PËR
PUNËN SEZONALE
TË DEKLARUAR**

#Rights4AllSeasons

#EU4FairWork

SIGURIMET SHOQËRORE

Sigurohuni që kontrata e punës të përfshijë mbulimin nga sigurimet shoqërore. Këtu përfshihen të drejtat e mëposhtme dhe jo vetëm:

- ▶ Trajtimi baras me shtetasit e Shtetit Anëtar pritës në BE kundrejt llojeve të ndryshme të sigurimeve shoqërore (sëmundje, paafësi dhe pleqëri).
- ▶ Qasja në arsim dhe formim profesional si dhe këshillimi nga zyrat e punësimit dhe shërbimet e tjera publike për punën sezonale.

AKOMODIMI

Ju keni të drejtë për kushte jetese dinjitoze, kur ato rregullohen nga punëdhënësi apo nëpërmjet tij.

- ▶ Qiraja nuk duhet të jetë shumë e shtrenjtë krahasuar me pagën tuaj neto ose me alternativa të ngjashme strehimi.
- ▶ Qiraja nuk duhet të zbritet automatikisht nga paga.
- ▶ Strehimi duhet të garantojë standard të përshtatshëm jetese.
- ▶ Strehimi duhet të përmbushë standardet e përgjithshme për shëndetin dhe sigurinë në atë shtet.

ANKIMI

Në rast se të drejtat tuaja janë shkelur, keni të drejtë të ankoheni.

- ▶ Ankohuni kundër punëdhënësit, direkt ose nëpërmjet një pale të tretë, duke përdorur mekanizmat kombëtarë për sa më poshtë dhe jo vetëm:
 - diskriminimin dhe trajtimin e pafavorshëm në vendin e punës për shkak të kombësisë, fesë ose etnisë;
 - mosmarrjen e pagës;
 - ngacmimin në vendin e punës.
- ▶ Gëzoni të njëjtën qasje të zgjidhjet ligjore si shtetasit e Shtetit Anëtar pritës në BE.

E DREJTA PËR PËRFAQËSIM

Jeni i lirë të anëtarësoheni në sindikata ose organizata të tjera që përfaqësojnë punëtorët në sektorin tuaj.

- ▶ Gëzoni të drejtën për liri organizimi dhe anëtarësim në sindikata për mbrojtjen e të drejtave tuaja në mënyrë kolektive.
- ▶ Keni të drejtën për grevë dhe për veprime sindikale.

PIKAT E KONTAKTIT

**Keni pyetje të tjera? Keni nevojë për ndihmë?
Kontaktoni institucionet e mëposhtme për
informacionet e nevojshme rreth punës sezonale
të deklaruar:**

- ▼ Pikat kombëtare të kontaktit ose faqet zyrtare të internetit.
- ▼ Kontaktoni pikat kombëtare të kontaktit të vendin tuaj, për shembull ambasadat ose konsullatat.
- ▼ Fushata e agjencisë ELA për të mësuar më shumë për të drejtat tuaja.



https://twitter.com/EU_ELA

<https://www.facebook.com/europeanlabourauthority>

<https://www.linkedin.com/company/european-labour-authority>

Gjeni më shumë informacion për të drejtat tuaja dhe për fushatën #Rights4AllSeasons. Skanoni kodin QR për të konsultuar faqen tonë të internetit.